



Komuna Vushtri


REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1841/24

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 31.12.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



N.P.L "Përparimi" Sh. A. - Vushtri

Në mbështetje të nenit 9 par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 19.09.2011, nenit 17, pika (f) dhe (p) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 04.06.2008, nenit 79, shkronja (e), (h), (i), (q), (s) të Statutit të Komunës i miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrisë me datë 28.04.2011, Vendimin e Kuvendit të Komunës 01Nr. 129/19 të datës 25.04.2019 për krijimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Përparimi" Sh. A. në Vushtri, me datën **31.12.2024**, arrihet kjo:

MARRËVESHJE (PËR KRYERJE TË SHËRBIMEVE KOMUNALE NË KOMUNËN E VUSHTRISË)

Në mes të:

- **Komunës së Vushtrisë**, me seli në qytetin e Vushtrisë, rr. Isa Boletini, nr. 10, e përfaqësuar nga z. Ferit Idrizi – Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejme – Komuna).

dhe

- **N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtri**, me seli në qytetin e Vushtrisë, rr. Gjergj Kastriot Skënderbeu, nr. 84, përfaqësuar nga Z. Fadil Bahtiri, Kryeshef Ekzekutiv (në tekstin e mëtejme Ndërmarrja).

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i marrëveshjes është:

- 1.1 Përcaktimin e shërbimeve të cilat ndërmarrja do t'ia ofrojë komunës në bazë të standardeve të kërkuara, mënyrën e ofrimit, operimit dhe menaxhimit të këtyre shërbimeve në bazë të kësaj marrëveshje.
- 1.2 Ndërmarrja dhe komuna pajtohen që t'i kryejnë obligimet e specifikuar në këtë marrëveshje si: kryerjen cilësore të shërbimeve publike duke përfshirë specifikimet e shërbimeve, monitorimin e performancës së kryerjes së shërbimeve si dhe raportimin.

Neni 2

Përkufizimet

1. Përkufizimet në këtë marrëveshje kanë këtë domethënie:

- 1.1 Komuna** – nënkupton Komunën e Vushtrrisë.
- 1.2 Ndërmarrja** – nënkupton ndërmarrjen publike komunal “Përparimi” Sh. A.
- 1.3 Mirëmbajtja e hapësirave publike komunale** – përfshin një sërë aktivitetesh që synojnë të mbajnë hapësirat publike komunale, të sigurta dhe të përdorshme për komunitetin dhe që përfshijnë aktivitetet si në vijim: kositjen, grabuimi, mbjelljen e drunjve, luleve, prashitjen e drunjve, luleve, largimin e deponive ilegale etj, të hapësirave publike që menaxhohen nga komuna.
- 1.4 Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik** – nënkupton ndërmarrjen e sërë aktivitetesh që synojnë të sigurojnë që rrugët, parqet dhe hapësirat e tjera publike të jenë të ndriçuara mirë dhe të sigurta dhe që përfshin mirëmbajtjen e ndriçimit publik ekzistues, zgjerimin e ndriçimit publik dhe përmirësimin e teknologjisë së ndriçimit publik.
- 1.5 Dënimi kontraktues** – nënkupton shumën e caktuar të të hollave që debitori detyrohet t’ia paguajë kreditorit në qoftë se nuk e përmbushë detyrimin e tij ose vonohet në përmbushjen e tij.
- 1.6 Zgjidhja e kontratës për shkak të mos përmbushjes** – nënkupton kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e saj, meqë rast pala tjetër mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose mund të kërkojë zgjidhjes e kontratës me një deklaratë të thjeshtë.
- 1.7 Faturë** – nënkupton një dokument i besueshëm i cili i dërgohet debitorit për përmbushjen e detyrimit nga ana e tij.
- 1.8 Gjinia** – fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.
- 1.9 Njëjës/shumës** - njëjësi do të nënkuptojë shumësin dhe anasjelltas.

Neni 3

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje vlen për periudhën kohore nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2027.

Neni 4

Shërbimet që i ofron ndërmarrja

1. Ndërmarrja sipas kësaj marrëveshje i kryen shërbimet e shënuara si në vijim:
 - 1.1 Mirëmbajtjen e hapësirave publike komunale që nënkupton:
 - 1.1.1 Kositja, grabuimi dhe bartja e barit në/nga të gjitha hapësirave publike të gjelbëruara, e që përfshijnë hapësirat si në vijim: Shëtitoren “Enver Zymberi” dhe shëtitoren në qytet në të dy anët e lumit Silnica, fushën e futbollit në fsh. Dobërllukë, varrezat e qytetit (varrezat e konservuara dhe ato aktuale), varrezat e fshatit (së paku dy (2) herë në vit), hapësirat përreth varrezave të dëshmorëve, martirëve, lapidarëve, pllakave përkujtimore përmendoreve, oborrit e Qendrës për Punë Sociale, oborrit e Shoqatave të dala nga Lufta, dhe jo vetëm, të cilat menaxhohen nga komuna. Çmimi për m² është 0.20€uro.
 - 1.1.2 Mirëmbajtja e anësoreve të shtratit të Lumit Silnica. Çmimi për m² është 0.25 €uro.

- 1.1.3** Mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve “Tërstena” dhe “Podranqa” dhe hapësirave gjelbëruese përgjatë lumenjve e cila duhet të bëhet së paku një (1) herë në javë. Çmimi për m² është 0.30 Euro.
- 1.1.4** Blerja dhe mbjellja e drunjve dekorativ gjatë sezonës. Me çmime për blerje dhe mbjellje si në vijim:
- 1.1.4.1** Çmimi për blerjen e pishave në vlerë prej 15.00 Euro për copë.
- 1.1.4.2** Çmimi për blerjen e drunjve të tjerë me diametër 8-10 cm në vlerë prej 80.00 Euro për copë.
- 1.1.4.3** Çmimi për mbjelljen e drunjve dekorativ në vlerë prej 5.00 Euro për copë.
- 1.1.5** Prashitjen e drunjve dekorativ gjatë sezonës sipas nevojës. Çmimi për copë 2.00 Euro.
- 1.1.6** Krasitjen e drunjve dekorativ gjatë sezonës së paku një herë në vit. Çmimi për një copë (dru dekorativ) është 3.00 Euro.
- 1.1.7** Ujitja e drunjve dekorativ, sipas nevojës për ujitje. Çmimi për copë 1.50 Euro.
- 1.1.8** Blerja dhe Mbjejlja e luleve në vende të caktuara, gjatë sezonës. Çmimi për një copë (fidan i luleve për blerje dhe mbjellje) është 1.50 Euro.
- 1.1.9** Ujitja e lulave dhe barit nga dhjetë (10) deri në njëzetë (20) herë në muaj gjatë sezonës së verës e në rast nevoje më shpesh. Çmimi për m² të ujitur është 0.30 Euro.
- 1.1.10** Prashitja e lulave. Çmimi për m² do të jetë 0.30 Euro.
- 1.1.11** Blerja dhe mbjellja e barit artificial në hapësirat publike të kërkuar paraprakisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Çmimi për m² është 1.30 Euro.
- 1.1.12** Pastrimin nga bora të hapësirave publike komunale, sipas kërkesës paraprake të Drejtorisë për Shërbime Publike. Çmimi për m² 0.20 Euro.
- 1.1.13** Debllokimi i kanalizimeve në Komunën e Vushtrisë sipas kërkesës paraprake nga ana e Drejtorisë për Shërbime Publike. Çmimi për një shërbim (debllokim) është 90.00 Euro .
- 1.1.14** Grumbullimi dhe bartja e mbeturinave të riciklueshme tek fabrika e riciklimit në fshatin Bukosh. Çmimi për kontejnerë 240l është 2.00 Euro, dhe 1.1m³ është 3.00 €.
- 1.1.15** Pastrimi i përroskave dhe kanaleve në Komunën e Vushtrisë sipas kërkesës paraprake nga ana e Drejtorisë për Shërbime Publike me çmime si në vijim:
- 1.1.15.1** Çmimi për orë me rastin e pastrimit të përroskave dhe kanaleve me anë të bagerit është 70.00 Euro.
- 1.1.15.2** Çmimi për orë me rastin e pastrimit të përroskave dhe kanaleve me anë të kamionit është 50.00 Euro.
- 1.1.16** Vendosja e flamujve (së bashku me shtiza) kombëtar, shtetëror, apo të aleatëve në qytet, memoriale, lapidare, varreza të dëshmorëve dhe martirëve. Çmimi për një (1) flamur të vendosur është 2.50 Euro.
- 1.1.17** Largimi i deponive ilegale në Komunën e Vushtrisë.
- 1.1.17.1** Çmimi për orë me rastin e largimit të deponisë me anë të bagerit është 70.00 Euro.

1.1.17.2 Çmimi për orë me rastin e largimit të deponisë me anë të kamionit është 50.00 Euro.

1.1.18 Bartja e inventarit të demoluar nga objektet e komunës. Çmim për bartjen e inventarit të dëmtuar është 3.00 Euro për 1km.

1.2 Mirëmbajtjen - pastrimin e objekteve të institucioneve publike të komunës, (objektet e Arsimit, Shëndetësisë dhe Administratës së Komunës) që nënkupton:

1.2.1 Kryerjen e shërbimeve të pastrimit të të gjitha hapësirave të shkollave të arsimit të mesëm, dhe arsimit parashkollor, si dhe objektet përcjellëse të tyre.

1.2.1.1 Shërbimi i pastrimit të të gjitha hapësirave të shkollave të arsimit fillor, me kërkesë paraprake nga Drejtoria për Arsim.

1.2.2 Kryerjen e shërbimeve të pastrimit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në qendrat dhe ambulantet e mjekësisë familjare në të gjithë Komunën e Vushtrisë.

1.2.3 Kryerjen e shërbimeve të pastrimit të të gjitha hapësirave të objekteve të Administratës së Komunës që përfshijnë si në vijim: Objektin e Komunës si dhe objektet tjera të administratës komunale jashtë objektit të komunës si Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina", Palestra Sportive në Vushtri dhe në Samadrexhë, Muzeu i Qytetit, Qendra Rinore "Naxhije dhe Fahri Buqinca", Qendra për Punë Sociale, dhe Qendra Rezidenciale Lumadh, përfshirë pastrimin e xhamave.

1.2.4 Pastrimin e xhamave të jashtëm të Objektit të Komunës, dhe objekteve tjera të Komunës, në bazë të kërkesës paraprake të tyre. Çmimi për m² është 3.00 Euro.

1.2.5 Pastrimi përfshinë: pastrimin e zyrave dhe inventarit, pastrimin e korridoreve, shkallëve, tualeteve, dritareve dhe sipërfaqe ve para hyrjeve të objekteve të cekura më sipër për pastrim.

1.2.6 Pastrimi duhet të bëhet një herë në ditë pas përfundimit të orarit të punës në administratë përkatësisht përfundimit të orarit të mësimi në shkolla.

1.2.7 Gjithashtu duhet të caktohet nga një pastrues/e kujdestar për intervenime në objektet e cekura në nënpikën 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3, në rast të paraqitjes së nevojës për pastrim.

1.2.8 Për shërbimet e kryera si në nënpikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3, Komuna do të paguajë mjete financiare nga buxheti i Drejtorive përkatëse, dhe atë në vlerë prej 495.60Euro për punëtorë të angazhuar.

Neni 4

Shërbimet e recepsionistit - roje

1. Shërbimet e recepsionistit - roje të objekteve të institucioneve publike të komunës (Objektet e Arsimit, Shëndetësisë dhe Administratës së Komunës), që nënkupton:

1.1 Shërbimin e lartcekur në të gjitha objektet arsimore (shkollat dhe objektet përcjellëse).

1.2 Shërbimin e lartcekur në të gjitha objektet shëndetësore dhe objektet përcjellëse, (QMF dhe AMF) në gjithë komunën e Vushtrisë, Qendrën për Punë Sociale dhe Qendrën Rezidenciale në Lumadh.

- 1.3 Shërbimin e lartcekur në të gjitha objektetve të administratës së komunës dhe objektet përcjellëse;
- 1.4 Për shërbimet e kryera si në nënpikat 1.3.1, 1.3.2 dhe 1.3.3, Komuna do të paguajë mjete financiare nga buxheti i Drejtorive përkatëse
- 1.5 Për shërbimin e kryer sipas nën pikave 1.3.1, 1.3.2 dhe 1.3.4, Komuna do të paguajë mjete financiare nga buxheti i Drejtorive përkatëse, dhe atë në vlerë prej 495.60€uro për punëtorë të angazhuar.

Neni 5

Zgjerimi dhe Mirëmbajtja e Ndriçimit Publik

1. Paramasa dhe para llogaria për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik ekzistues në qytet dhe fshatra (kontratë kornizë)

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Çmimi për njësi/copë(€)
	Ormanat dhe pajisjet ne ormana		
1	Furnizimi, montimi dhe lidhja e kuadros shpërndarëse elektrike të ndriçimit KESHN t i ndërtuar nga metali dhe i ngjyrosur me ngjyre antikorodive me dim : 1200x900x300 mm, me mbyllje hermetike te kapakut dhe me qelës trekëndësh (univerzal) . Kuadri vendoset në bazamentin prej betoni MB30 të përgatitur konform normave teknike. Pajisja që montohet në kuadër duhet të jetë nga materiali që nuk ndryshket kurse të gjitha lidhjet të mbrohen nga korozioni. Kuadri duhet të përmbajë këto elemente: 1. Ndërprerës automatik, 3P, magneto-termik, Tip DPX 100-A 2. Siguresat automatike katërpolare 32A ; -16A ; - 6A 3. Kontaktorët për kyçe automatike të ndriçimit C-44 ,380V 4. Releun digjital astrologjik për aktivizimin automatik tw ndriçimit 5. Voltmetrin për kontrollimin e vlerës së tensionit në faza 6. Paket ndërpresin për kapërcim të tregimit të voltmetrit në faza 7. Prizën njëpolare për shërbime e servisine brenda kuadrit 8.Llambën ndiçuese në brendi të kuadrit 9.Zbarrat prej bakri për lidhjen dhe përforcimin e përçuesve në faza, zbarrën e përçuesve të zeros dhe zbarrën e përtokzimit, 10.Shkarkuesit katodik dhe zbarrën për barazimin e	copë	250.00

	potencialit. 11. Siguresat thikore 63 A ,3 copë; Të gjithë elementet elektrik duke përfshirë dhe ormanët distributiv duhet të jenë të ndërtuar sipas normave teknike CE dhe IEC. Komplet kuadri shpërndarës elektrik i ndriqimit KESHN deri të shtylla më e afërt. Lidhja e elemnteve duhet te behet ne baze te skemes njekahore të kuadrit shperndares.		
2	Furnizimi dhe montimi i kontaktorit per kyçje automatike te ndriqimit C-44 ,40A,380V	Copë	70.00
3	Furnizimi dhe montimi i relesë IC ASTRO Shnider,Siemens,ABB ose e ngjajshme	Copë	55.00
4	Furnizimi dhe montimi i fotosenzorit ST210-220V-10A.	Copë	20.00
5	Furnizimi dhe montimi i relesë kohore per ndalje automatike te ndriqimit	Copë	40.00
6	Furnizimi dhe montimi i siguresave thikore 160A të vendosura në trafo për furnizim të ormanëve ndriçues	Copë	3.50
7	Furnizimi dhe montimi i siguresave thikore 63A NH 00.	Copë	4.50
8	Furnizimi dhe montimi i pllakave Aradit RP4 me siguresë FRA 16A.	Copë	5 .00
9	Furnizimi dhe montimi I bazamenteve te siguresave	Copë	5.00
10	Furnizimi dhe vendosja e siguresave automatike Schneider ose e ngjashme 16, 25,32 A, e vendosur në ormanin e grupit matës.	Copë	5.00
11	Furnizimi dhe montimi i bazave të çelësave në dyer të ormanëve	Copë	5.00
12	Dislokimi i ormanit te ndriqimit publik. Kërkohet nga KEDS kur bëhet zëvendësimi i rrjetit elektrik	Copë	7.00
13	Furnizimi dhe montimi i dyerve te ormanve te ndriqimit. Vlenë për ormanët e dëmtuar	Copë	15.00
14	Trup ndriçues i teknologjisë LED me fuçi 50 W. Nga aspekti i dizajnit dhe cilësisë duhet t'i plotësojë standardet evropiane, EN 60598-2-3, EN 55015 dhe të ketë : - mbrojtje mekanike IP 66 - qëndrueshmëri pune $\geq 50000h$ - efienca e LED-it $\geq 135 \text{ Lm/W}$ - temperaturë ngjyre $\leq 5000 \text{ K}$ -tension pune 85-265 V(50 Hz) - faktor fuqie ≥ 0.92 -mbrojtje në goditje IK 10 -garancion ≥ 3 vite	Copë	50.00

15	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese LED E021/70W /WH/5000K llampa nga aspketi i dizajnit duhet ti plotësojë standardet Europiane, EN 60598-2-3, EN 55015 DHE të ketë; Mbrojtje : IP66. Qëndrueshmëri pune $\geq 50000(h)$ Efiçienca min 135 lm/W Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës: $\leq 5000K$ VREJTJE Tension pune: 85....265V (50Hz) Faktor të Fuqisë: ≥ 0.92 Temperaturë pune: $(-40...+60)^{\circ}C$ Mbrojtje nga goditja: IK10 Garancion ≥ 3 vite.	Copë	65.00
16	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese VREJTJE LED E021/100W /WH/5000K Llampë nga aspketi i dizajnit duhet ti plotësojë standardet Europiane, EN 60598-2-3, EN 55015 DHE Të KETë; Mbrojtje : IP66. Qëndrueshmëri pune $\geq 50000(h)$ Efiçienca min 130 lm/W Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës: $\leq 5000K$ VREJTJE Tension pune: 85....265V (50Hz) Faktor të Fuqisë: ≥ 0.92 Temperaturë pune: $(-40...+60)^{\circ}C$ Mbrojtje nga goditja: IK10 Garancion ≥ 5 vite.	Copë	85.00
17	Trup ndriçues dekorativ me fuqi 24 W per montim ne tokë, materiali çelik inox , sipas standardit EN 60598-2-3, EN 55015 dhe të ketë xham të zbutur. T = 10 mm, mbrojtje mekanike IP 67 qendrueshmeri pune $\geq 50000h$, efiçienca e LED-it ≥ 120 Lm/W, temp. e ngjyres ≤ 4000 K, tension pune 100-270 V(50 Hz) , garancion ≥ 3 vite	Copë	23.00
18	Furnizimi dhe montimi i trupit ndriçues dekorativ per sheshe ose parqe me dimensione 750mm x 450 mm diametri per montim ne shtyllën e metalit te jetë Ø60 mm te njejta me ato ekzistuese me poç LED 30W, temp. e ngjyres ≤ 4000 K	Copë	80.00

19	Furnizimi dhe montimi i reflektorëve ndriçuese LED E021/50W /WH/5000K Lampa nga aspekti i dizajnit duhet ti plotësojë standardet Europiane, EN 60598-2-3, EN 55015 DHE Të KETë; Mbrojtje : IP66.Qëndrueshmëri pune $\geq 50000(h)$ Eficiencë min 135 lm/W Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës:$\leq 5000K$ VREJTJE Tension pune: 85....265V (50Hz) Faktor të Fuqisë:≥ 0.92 Temperaturë pune:$(-40...+60)^{\circ}C$ Mbrojtje nga goditja:IK10 Garancion ≥ 3 vite.	Copë	65.00
20	Furnizimi dhe montimi i reflektorëve ndriçuese LED E021/100W /WH/5000K Lampa nga aspekti i dizajnit duhet ti plotësojë standardet Europiane, EN 60598-2-3, EN 55015 dhe të ketë; Mbrojtje : IP66.Qëndrueshmëri pune $\geq 50000(h)$ Eficiencë min 135 lm/W Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës:$\leq 5000K$ VREJTJE Tension pune: 85....265V (50Hz) Faktor të Fuqisë:≥ 0.92 Temperaturë pune:$(-40...+60)^{\circ}C$ Mbrojtje nga goditja:IK10 Garancion ≥ 3 vite.	Copë	70.00
21	Furnizimi dhe montimi i reflektorëve ndriçuese LED E021/150W /WH/5000K Lampa nga aspekti i dizajnit duhet ti plotësojë standardet Europiane, EN 60598-2-3, EN 55015 dhe të ketë; Mbrojtje : IP66.Qëndrueshmëri pune $\geq 50000(h)$ Eficiencë min 130 lm/W Në 50000 (h/punë) të LEDIT- L70/B20 Temperaturë të ngjyrës:$\leq 5000K$ VREJTJE Tension pune: 85....265V (50Hz) Faktor të Fuqisë:≥ 0.92 Temperaturë pune:$(-40...+60)^{\circ}C$ Mbrojtje nga goditja:IK10 Garancion ≥ 3 vite.	Copë	75.00
22	Furnizimi dhe vendosja e kabllorës së ndriçimit publik 2x16 mm²- X00-A-Al për ndriçimin e lagjeve	m'	3.15

23	Furnizimi dhe montimi i kabllos ajrore nga alumini 4X16mm ² me izolim XLPE, 0.6/1kV ABC, me standard HD 626-S1	m'	4.30
24	Furnizimi dhe montimi i kabllos PPOO (Cu) 3x2.5 mm ² 2m per trup ndriçues	m'	2.00
25	Furnizimi dhe montimi i kabllos furnizuese NAYY - AL-4x50mm ² ,për furnizim të KKSH nga shtyllat e tensionit, trafos 0.4kv tokësore.	m'	3.00
26	Furnizimi dhe vendosja e kabllos për furnizimin e trupave ndriçuese NAYY (Al) 4x25mm ² prej KKSH-së tokësore.	m'	2.50
27	Furnizimi dhe vendosja e kabllos për furnizimin e trupave ndriçuese NAYY (Al) 4x16mm ² prej KKSH-së tokësore.	m'	2.30
28	Furnizimi dhe montimi i kabllos PPOO 4x4 mm ²	m'	2.10
29	Furnizimi dhe montimi i papuqeve për lidhjen e kabllove në orman për 4x50mm ² Al-Cu	Copë	2.50
30	Furnizimi dhe montimi i papuqeve për lidhjen e kabllove në orman për 4x16mm ² Al-Cu	Copë	1.90
31	Furnizimi dhe montimi i Lidhëseve (klema) "Unimax", Al – Cu ose të tjerë, për vazhdimin e përçuesve në kablo, shtylla të betonit dhe të drunjëta, me dim. 50,35,25 dhe 16 mm ²	Copë	2.00
32	Furnizimi dhe montimi i tërheqësës së kabllit bistek	Copë	1.90
33	Furnizimi dhe vendosja e hallkave për shtylla të betonit (me diameter perkates te shtylles)	Copë	4.00
34	Furnizimi dhe montimi i vazhduesve kabllovik (muf) me dim. 50, 25, dhe 16mm ²	Copë	2.50
35	Furnizimi,transporti dhe montimi i shtyllave metalike të ndriçimit të zingura konike, njëtrajtësisht e punar (pa saldim të pjesëve) me lartësi H=9m , ose H=10 m, Φ=148/60 me pjesë në shtyllë duke përfshirë kapakun, pllaken e araldidit , pllakën për vendosjen e klemave, kabëll lidhëse (3x2.5mm ² Cu) , siguresë 16 A dhe materialit tjetër të nevojshëm. Shtylla duhet të jetë e ndërtuar sipas standardit ISO UN EN ISO 1461 standardi i zingimit e galvanizuar si dhe pjekja e ngjyrës në furrë (kodi RAL 9011) sipas standardit ISO 12944-5 .shtylla duhet te realizohet me mbjellje.	copë	260.00

36	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllës së metalit e zinguar H = 9.00 m , trashësi të mureve 4mm, me siguresë 16A, kabull lidhëse (3x2.50mm ² Cu) dhe material tjetër të nevojshëm. Komplet. Shtylla të realizohet me ankerim	copë	260.00
37	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllës së metalit e zinguar H = 5.00 m , trashësi të mureve 4mm, me siguresë 16A, kabull lidhëse (3x2.50mm ² Cu) dhe material tjetër të nevojshëm. Komplet. Shtylla mund të realizohet ose me ankerim ose me mbjellje	copë	180.00
38	Furnizimi dhe montimi i kapakve metalik adekuat për shtylla te ndriçimit, të përforcuar me bulona përkatëse për mbrojtjen e siguresave të vendosura në shtyllë të metalit të pajisur me gomë përkatëse për mbrojtje të kabllave nga pluhuri dhe lagështia. Për të gjitha llojet e shtyllave. Vërejtje: nuk pranohet pjesë nga llamarina e prerë	copë	5.00
39	Drejtimi i lirës së lakuar nje dhe dy krahshe se bashku me trupin ndriçues	copë	4.00
40	Furnizimi dhe montimi lirës harkore njëkrahshë Ø48 mm e galvanizuar, gjatësia >1.00 m	copë	8.00
41	Zhvendosja e trupave ndriçues nga shtylla e drurit ose e betonit dhe montimi në shtyllen e re të betonit, komplet. Vërejtje: Ky pozicion kërkohet nga KEDS gjatë dislokimeve. Të gjitha llojet e trupave ndriçues.	copë	1.50
42	Zhvendosja e kabllave ndriçuese 2x16 mm ² nga shtylla e drurit ose betonit në shtyllen e re të betonit. Vërejtje: Ky pozicion kërkohet nga KEDS gjatë dislokimeve.	copë	1.00
43	Zhvendosja e kabllave ndriçuese 4x16 mm ² nga shtylla e drurit ose betonit në shtyllen e re të betonit. Vërejtje: Ky pozicion kërkohet nga KEDS gjatë dislokimeve.	copë	1.10
44	Furnizimi dhe shtrirja e shiritit Fe Zn 25x 4mm, lidhëseve katrore dhe materiali tjetër i nevojshëm për tokëzimin e shtyllave të metalit. Komplet.	m'	1.20
45	Matja e tokzimit mbrojtës dhe dhënja e atestit të tokëzimit për çdo shtyllë	copë	7.00
46	Largimi i shtyllës së drurit e cila shërben vetem për ndriçim te rrugës sipas urdhërit nga Policia e Kosovës ose porosisë nga menaxheri i kontratës	copë	10.00
47	Largimi i shtyllës metalike të ndriçimit sipas urdhërit të Policisë së Kosovës ose porosisë nga menaxheri i kontratës	copë	10.00
48	Drejtimi i shtyllës së lakuar të H= 10,00 – 9.00 – 8.00 m , 6.00m, saldimi i tokëzimit, furnizimi me ankera si dhe shtrëngimi i shtyllës.	copë	20.00

49			
50	Sonda për pertokëzim 75mm/1500m	copë	8.00
51	Hapja e vrimës për bazament të shtyllës vendosja e rethit të betonit Ø600 betonimin në vend thellësia 1.50cm	copë	15.00
52	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave të betonit H-9m bartese 30 shkallë.	copë	120.00
53	Punimi i bazamentit për shtylla të metalit prej betonit MB 30 me bulona dhe material tjetër të nevojshëm. (0.80x0.80x0.80)m. komplet.	copë	35.00
54			
55	Punimi i bazamentit prej betonit MB 30 për vendosjen e ormanëve të grupit matës sipas skicës dim 1.30x0.80x0.50m me gypa PVC Ø63mm. Komplet.	copë	40.00
56	Identifikimi i prishjes së kabllos me makinë speciale	copë	10.00

Neni 5 Faturimi dhe pagesa

1. Komuna do të kryejë pagesat në baza mujore për shërbimet e kryera nga ndërmarrja në llogarinë bankare, me nr. 1707017600221853 në NLB Bank Kosovo.
2. Pagesa do të bëhet pas pranimi të faturës nga ndërmarrja dhe raportit të aprovuar nga Komisioni Mbikëqyrës.
3. Dorëzimi i faturës dhe raportit të organit mbikëqyrës për punëtor të mirëmbajtjes - pastrimit dhe punëtorëve të recepsionit - rojes mund të bëhet në fund të çdo muaji pas kryerjes së shërbimit por jo më larg se data 2, ndërsa pagesa në llogari të kryesit të shërbimeve do të bëhet më së largu deri me datën 5 të secilit muaj.
4. Nëse data 1 dhe 5 korrespondon me ditë pushimi, atëherë pagesa bëhet në ditën e parë pasuese të punës.
5. Komuna e Vushtrisë me rastin e kryerjes së pagesave për shërbimet e kryera nga ndërmarrja do të përfshijë dhe TVSh-në.
6. Nëse ndërmarrja vonon dorëzimin e faturës për shërbimin e kryer pas datës 5 të muajit pasues, atëherë pagesa e shërbimit do të shtyhet për aq ditë sa është vonuar dorëzimi i faturës.
7. Pagesa për shërbimet e kryera si në nenin 4 të kësaj marrëveshje do të bëhet pas pranimi të faturës dhe raportit të organit mbikëqyrës.
8. Ndërmarrja ia ofron komunës sipas nevojës një regjistër të azhurnuar të faturave që janë lëshuar dhe pagesave që janë pranuar, të ndara sipas llojeve të shërbimit.

Neni 6

Përgjegjësitë tjera të ndërmarrjes

1. Ndërmarrja siguron tërë personelin dhe pajisjet e nevojshme për të ofruar një shërbim të kënaqshëm, në mënyrë që të jetë në përputhje me specifikacionet e shërbimit që janë përfshirë në këtë Marrëveshje.
2. Ndërmarrja do të sigurohet që të gjitha faturat për shërbimet e kryera t'ia dorëzojë me kohë Komunës.
3. Ndërmarrja sipas nevojës apo kërkesës së komunës do të ketë autorizim me shkrim që të kontrollojë të gjitha veturat, njerëzit, çantat dhe gjësendet tjera para se të dalin apo të hyjnë në objekt apo pronën të cilën e ka nën përkujdesje, po ashtu në bazë të kësaj marrëveshje do të ketë të drejtën që të përcjellë kamerat që gjenden në objektin e komunës.
4. Ndërmarrja do të mbajë përgjegjësi vetëm për pasurinë që është brenda zonës së përgjegjësisë së tij, sipërfaqen që është e kufizuar me portë, rrethojë apo sipërfaqe e ndriçuar.
5. Ndërmarrja nuk mban përgjegjësi për humbje apo dëmtim si pasojë e ngjarjeve që paraqiten jashtë mundësisë së vet të arsyeshme për t'i kontrolluar, duke përfshirë trazirat, luftën, terrorizmin, sulmet e armatosura, dridhjet e tokës, si dhe fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të parapara me ligj.

Neni 7

Obligimet tjera të parapara

1. Ndërmarrja siguron numër adekuat të punëtorëve me shkathtësinë dhe trajnimin e duhur për t'i kryer shërbimet sipas kësaj Marrëveshje.
2. Në rast të paraqitjes së nevojave për shtim të numrit të punëtorëve të mirëmbajtjes/pastrimit apo të punëtorëve të recepsionit - rojeve për kryerje të shërbimeve ndaj komunës, do të bëhet pagesë shtesë e mjeteve nga buxheti i komunës në llogari të ndërmarrjes në bazë të kriterëve të njëjta të pagesave, për shërbime shtesë që do të kryhen.
3. Vlerësimin e nevojave për rritjen e numrit të punëtorëve që kryejnë shërbime të pastrimit dhe recepsionit e bën menaxhmenti i ndërmarrjes duke njoftuar menaxherin e kontratës për numrin e punëtorëve që do t'i angazhojë dhe pikat që do t'i sistemojë, me përjashtim të të punëtorëve që do të angazhohen në kuadër të arsimit fillor, ku nevojitet kërkesa paraprake e drejtorisë për arsim.
4. Komuna pas pranimit të njoftimit sipas par. 3 të këtij neni, do të bëjë pagesën shtesë sipas par. 2 të këtij neni.

Neni 8

Nën kontraktimi

Ndërmarrja mund të hyjë në marrëdhënie nën kontraktimi me ndonjë nën kontraktor tjetër për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje duke respektuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Neni 9

Përgjegjësitë e komunës

1. Komuna do të kryejë pagesat për shërbimet e kryera nga ndërmarrja në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara në nenin 5 të kësaj marrëveshje.
2. Komuna cakton një komision prej tre (3) anëtarësh për mbikëqyrje të realizimit të kësaj marrëveshje, për sa i përket shërbimeve të pastrimit të objekteve publike të komunës si dhe recepsionit. Komisionin e përbëjnë: nga një zyrtar nga administrata e komunës, arsimi dhe shëndetësia.
3. Komisioni nga par. 3 i këtij neni caktohet me vendim të kryetarit të komunës pas marrjes së propozimeve nga drejtoritë përkatëse.
4. Komuna ka të drejtë po ashtu t'i inspektojë në çdo kohë lokacionet e parapara në këtë marrëveshje në të cilat ndërmarrja i kryen shërbimet, të vlerësojë performancën për shërbimet e kryera, zbatimin e standardeve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar në këtë marrëveshje.

Neni 10

Fuqia madhore

1. Nga ndërmarrja nuk do të kërkohet që t'i kryejë shërbimet që janë saktësuar në nenin 3 të kësaj marrëveshje, nëse pengohet për ta bërë këtë nga ndonjë fuqi madhore.
2. Me termin "Fuqi madhore" brenda kësaj marrëveshje nënkuptojmë një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale, e cila shkakton pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve të palës në këtë kontratë ose është jopraktike dhe konsiderohet e pamundur për shkak të rrethanave të krijuara. Ajo përfshinë, luftën, protestat e dhunshme, mosbindjen civile, tërmetin, zjarrin, shpërthimet, stuhitë, përmytjet etj.
3. Fuqia madhore nuk përfshin një ngjarje e cila shkaktohet nga neglizhenca apo veprimi me qëllim i njërës palë apo agentëve ose punëtorëve të saj, asnjë ngjarje të cilën një palë e kujdesshme në mënyrë të arsyeshme duhet ta kishte marr parasysh në kohën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe që mund të ishte shmangur ose tejkaluar me përmbushjen e detyrimeve në këtë kontratë.

Neni 11

Ndëshkimet në rast të mos përmbushjes së marrëveshjes

1. Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në këtë marrëveshje, atëherë Komuna e Vushtrrisë do t'i zbresë 5 % të faturës së shërbimit.
2. Nëse e njëjta përsëritet në muajin pasues, atëherë do të aplikohet dyfishimi i ndëshkimit që do të thotë se ndëshkimi do të jetë 10% zbritje nga pagesa e faturës së shërbimit.
3. Gjatë cilësdo fazë të zgjidhjes së pakënaqësisë apo kontestit, shërbimet që ende nuk janë ofruar në shkallën e dakorduar të standardit të përcaktuar në kuadër të dokumenti, mund të jenë shkas për një ndëshkim financiar që duhet të përcaktohet pas procesit të monitorimit nga komuna.

4. Komuna ka mundësi që në rast se ndërmarrja përmbush detyrimin në tërësi, të mos zbatojë dënimin e kontraktuar në zbritjen e faturës.
5. Komuna nuk ka të drejtë të kërkojë dënimin kontraktues për shkak të vonesës nëse i jep afat shtesë ndërmarrjes për të përmbushur detyrimin që ka në bazë të kësaj marrëveshje.
6. Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, ndërmarrja do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj marrëveshje

Neni 12

Vonesat në vazhdimin e kontratës

Nëse për shkaqe të arsyeshme shtyhet nënshkrimi i marrëveshjes së re ndërmjet palëve kontraktuese, dispozitat e kësaj marrëveshje do të mbeten në fuqi deri në nënshkrimin e marrëveshjes së re, por jo më gjatë se tridhjetë (30) ditë kalendarike nga dita e skadimit të marrëveshjes.

Neni 13

Rishikimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje dhe të gjitha pjesët përbërëse të saj do të rishikohen sipas nevojës dhe me kërkesë të Komunës apo ndërmarrjes.
2. Për çdo ndryshim/ndërrim në shërbimet e ofruara që do të ndikojë gjatë implementimit të kësaj marrëveshje duhet të dakordohen të dyja palët.

Neni 14

Zgjidhja e marrëveshjes për shkak të mos përmbushjes

1. Kjo marrëveshje mund të shkëputet me pajtimin e të dyja palëve me shkrim ose nëse cilado palë jep njoftim me shkrim për zgjidhjen e marrëveshjes për shkak të mos përmbushjes së kontratës, si nga aspekti i përmbushjes së detyrave nga ndërmarrja sipas nenit 3 të kësaj kontrate, apo detyrimit financiar të komunës sipas nenit 4.
2. Nëse ndërmarrja nuk i ofron shërbimet e dakorduara në përputhje me standardet e shërbimit që janë përcaktuar në këtë marrëveshje gjatë një periudhe të vazhdueshme prej tre (3) muajsh, kjo marrëveshje do të zgjidhet automatikisht dhe komuna nuk do të jetë e obliguar ta paguajë asnjë faturë të dorëzuar për shërbimet e ofruara gjatë kësaj periudhe, por që është e obliguar të dorëzojë tek ndërmarrja deklaratën e zgjidhjes.

Neni 15

Kontestet mes palëve

1. Kontestet që ndërlidhen me shërbimin e ofruar dhe të paguar në kuadër të kësaj marrëveshje zgjidhen në radhë të parë, gjatë takimeve kontaktuese operative të rregullta.
2. Çdo çështje që ka të bëjë me shërbimet e ofruara apo standardet e përshkruara në këtë marrëveshje dhe që mbetet e pazgjidhur pasi të jetë trajtuar fillimisht do të përpiqen t'i

zgjidhin me anë të negocimit, të ndërmjetësimit apo në ndonjë mënyrë tjetër me pajtimin e pjesëmarrësve.

3. Nëse asnjë zgjidhje nuk mund të arrihet midis ndërmarrjes dhe komunës, çështja duhet të iniciohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë.
4. Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja, ndërmarrja do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj marrëveshje, me përjashtim të rasteve kur caktohet masë e përkohshme në gjykatë.

Neni 16


Nënshkrimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje nënshkruhet në tri (3) kopje origjinale, dy (2) për komunën dhe një (1) për ndërmarrjen.


Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës



Fadil Bahtiri

Kryeshef Ekzekutiv

